

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR REGJISTRIM NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

(Përmbajtja e Dosjes individuale)

1. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, që është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të doktoratës, ku të përfshihet fusha e studimit të doktoratës, që kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
2. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
3. Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë, firmosur nga udhëheqësi;
4. Letër motivimi;
5. CV personale;
6. Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla;
7. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave, të shoqëruara me suplementet e diplomës. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
8. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
9. Fotokopje të kartës së indentitetit/pasaportës;
10. Dy fotografi;
11. Dy rekomandime nga persona me titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar”, ku njëri prej të cilëve duhet të mbulojë fushën përkatëse të kërkimit shkencor;
12. Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UPT (Kjo pikë plotësohet vetëm nga kandidatët të cilët nuk janë staf efektiv i UPT-së);
13. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas kornizës ligjore në fuqi;
14. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;
15. Mandat pagese për tarifën e aplikimit.(Jemi në pritje të miratimit të tarifës së aplikimit nga Bordi i Administrimit të UPT-së për të cilin do të njoftoheni. Aplikimet do të vijojnë pa dorëzimin e mandat pagesës për tarifën e aplikimit deri në daljen e këtij vendimi nga Bordi i Administrimit të UPT-së).